

VENDIM
Nr. 57, datë 29.1.2025

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “PLOTËSIMI, RAKORDIMI DHE VAZHDIMI I PUNIMEVE SHESHI ‘SHQIPONJA’ – LUMI I TIRANËS, LOTI 1 & QMT, FAZA 2”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve sheshi ‘Shqiponja’ – lumi i Tiranës, loti 1 & QMT, faza 2”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme, prej 103 096 750.18 (njëqind e tre milionë e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë pikë tetëmbëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 103 096 750.18 (njëqind e tre milionë e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë pikë tetëmbëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Autoritetin Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Autoritetin Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “PLOTËSIMI, RAKORDIMI DHE VAZHDIM I PUNIMEVE SHESHI ‘SHQIPONJA’ – LUMI I TIRANËS, LOTI 1 DHE QMT, FAZA 2”

Nr. rendor	Pronësi			Të dhëna katrore (sipas kartelesë së pronës)			Vleratimi për shpronësuar								Vlera totale (ëkë)	Shënime	
	Emri	Adresa	Mbiemri	Zona katrore	Numri i pronës	Lloji i pronës	Totali "totali"				Objekt banor						
							Sipërfaqja e shpronësuar m ²	Sipërfaqja e shpronësuar (m ²)	Gjatësi (m)	Lartësia (m)	Vlera	Sipërfaqja e shpronësuar m ²	Sipërfaqja e shpronësuar (m ²)	Gjatësi (m)			Lartësia (m)
1	Gjergj	Pjetër	Aliu	8310	2/20	Terrall	353.00					106.50	106.50	96,753.41	10,304,238.17	10,304,238.17	
2	Adem	Mark	Ndoci	8310	10/004	Terrall	108.90	14.2		31.215.00	443,309.80				443,309.80		
3	Zef	Mark	Sami	8310	10/008	Terrall	204.80	44.1		31.215.00	1,376,757.90				1,376,757.90		
4	San	Bashkim	Gala	8310	10/22	Terrall	296.80	31.3		31.215.00	977,154.70	87.60	87.60	96,753.41	8,475,098.72	9,452,253.42	
5	Edhe	Ogust	Daci	8310	10/074	Terrall	206.80	20		31.215.00	686,403.00				686,403.00		
6	Erjon	Mir	Gani	8310	10/073	Terrall	170.00	23.3		31.215.00	727,402.70				727,402.70		
7	Gjergj	Pjetër	Kala	8310	10/019	Terrall	252.00	23		31.215.00	718,037.00				718,037.00		
8	Urosh	Idjon	Mulla	8310	10/025	Terrall	78.00					43.70	43.70	96,753.41	4,228,124.02	4,228,124.02	
9	Agim	Zef	Gani	8310	11/000	Terrall	74.00					217.70	217.70	96,753.41	21,063,217.36	21,063,217.36	
10	Mir	Zef	Gani	8310	11/200	Terrall	307.50					270.40	270.40	96,753.41	26,162,122.06	26,162,122.06	
11	Idh	Gjergj	Sami	8310	10/079	Terrall	217.00	30.4		31.215.00	1,250,028.00				1,250,028.00		
12	Erjon	Skender	Shehi	8310	2/477-ND	Ndërruar						276	276	96,753.41	26,703,941.16	26,703,941.16	
Vlera totale							6,150,508.70								96,937,241.48	103,096,730.18	